
REFERATE E KUMTESA

BEQIR META**“DIELLI” DHE ZGJIMI KOMBËTAR NË FILLIMET
E SHEK. XX***

Zgjimi kombëtar i shqiptarëve kishte nisur në Amerikë qysh me botimin e gazetës “Kombi” nga Sotir Peci, më 12 qershor 1906. Tashmë një lëvizje kombëtare kishte filluar, e cila u dëshmuua me suksesin e shpejtë të arritur në themelimin e shoqërisë “Besa-Besë” dhe me themelimin e Kishës Autoqefale Shqiptare nga Fan Noli në vitin 1908. Kjo kishë ishte institucioni më i rëndësishëm në përhapjen e ndjenjave kombëtare shqiptare.

Gazeta “Dielli” filloi jetën e saj në vitin 1909, në një kohë kur emigrantët shqiptarë të Amerikës, të cilët ishin auditori i saj kryesor, vinin nga Shqipëria që kishte 4 shekuj nën sundimin osman dhe për këtë arsye ata, në përgjithësi, nuk kishin një koncept real e të plotë për identitetin kombëtar. Pikërisht këtu duket edhe kontributi i madh i “Diellit”, si gazeta më e fuqishme për zgjimin kombëtar të shqiptarëve. Një numër i madh i emigrantëve shqiptarë në fillim ishin ortodoksë shqiptarë të cilët, si dhe shumë bashkatdhetarë të tyre në Shqipëri, ishin ushqyer për një kohë të gjatë me ndjenja pro-greke. Ndërsa edhe mjaft myslimanë mbartnin paragjykimet që buronin nga sundimi i gjatë turk. Apostujt e nacionalizmit shqiptar kishin përpara një grup të vështirë me të cilin duhej të punonin. Pikërisht këtu del në pah roli i tyre dhe i “Diellit” në zgjimin kombëtar.

Në komunitetin shqiptaro-amerikan ekzistonin forca që po punonin për të shkatërruar lëvizjen kombëtare qysh në fillimet e saj. Këto ishin po ato forca që vepronin në trojet shqiptare të cilat përpiqeshin për ta mbajtur popullsinë të përçarë. Veçanërisht e rrezikshme ishte influenza e Greqisë midis emigrantëve ortodoksë që vinin nga jugu. Edhe në Amerikë priftërinjtë ortodoksë grekë, që u kryenin shërbesat fetare shqiptarëve ortodoksë në Massachusetts etj. propagandonin kundër përdorimit të gjuhës shqipe në kisha. Nga ana tjetër ndjeheshin pasojat e politikës turke e cila kishte nxitur antagonizmin midis shqiptarëve ortodoksë dhe myslimanë. Në Amerikë lëvizja nacionaliste ishte më

* Kumtesë e mbajtur në Konferencën Shkencore të organizuar nga Fedarata Panshqiptare “Vatra”, me rastin e 100-vjetorit të botimit të gazetës “Dielli”, New Jork, 13 qershor 2009.

pak e kërcënuar nga propaganda pro turke, se sa nga ajo pro greke. Myslimanët nuk ngritën xhamia, as nuk shkonin nëpër xhami të tjera. E gjithë influenza e islamit ushtrohej nga ndjenjat tradicionale. Ndërsa midis ortodoksëve shqiptarë shpërndaheshin ndjenja antikombëtare në mënyrë sistematike e me mjete efektive. Myslimanët gjithnjë e më shumë po e kuptonin se sundimit turk në Ballkan po i vinte fundi. Ndërsa Greqia ishte dinamike dhe ekspansioniste. Përveç kishës, një numër organizatash të tjera greke po zhvillonin propagandë midis shqiptarëve.

Fryma e lirisë që emigrantët shqiptarë gjetën në Amerikë ishte shtrati i ngrohtë ku do të kultivohej kjo ndërgjegje, por shqiptari atdhetar është vështirë të perceptohet si një njeri që nuk e kaloi në dorë “Diellin” ose, të paktën, që nuk u ngroh nga rrezet e tij.

Themelimi i kësaj gazete të lavdishme nga Fan Noli dhe publikimi i numrit të parë të “Diellit”, më 15 shkurt 1909, nën mbështetjen e shoqërisë “Besa-Besë”, përbën një nga tri monumentet që ai la për shqiptarinë: “Diellin”, “Vatrën” dhe Kishën Ortodokse Shqiptare. Po kështu edhe arritja e Faik Konicës, i cili shpejt do të bëhej editor i “Diellit”, ishin gurë themeli në zhvillimin e ndërgjegjes kombëtare dhe politike të emigrantëve shqiptarë në Amerikë.

Programi i “Diellit”, megjithëse ishte disi më pretendues, ishte në thelb identik me atë të “Kombit”. Qysh me themelimin e tij, motoja e “Diellit” ishte: “Pro autonomia Albania – Për autonominë e Shqipërisë”. “Dielli” dhe “Vatra” bashkuan të gjithë shqiptarët, në fillim për afirmimin e kombit shqiptar, për arritjen e autonomisë dhe pastaj të pavarësisë. Ai bënte thirrje për njohjen e kombit shqiptar nga qeveria turke; përcaktimin e kufijve territorialë të Shqipërisë; për lirinë e plotë të fesë dhe shtypit; eliminimin e shkollave fillore turke në Shqipërinë autonome; hapjen e shkollave për përmirësimin e bujqësisë, arteve, blegtorisë; ndërtimin e rrugëve dhe shfrytëzimin e burimeve natyrore me fondet e qeverisë turke; ndarjen e të drejtave të shqiptarëve dhe turqve, veçanërisht në çështjet ushtarake dhe të jashtme.

Në botimin e parë, më 15 shkurt 1909, “Dielli” formuloi në një mënyrë të thjeshtë e të kristaltë një politikë të jashtme e cila parashikonte gjithë rrethanat ballkanike. Shqipëria do të ishte pjesë e Perandorisë Turke, me të drejtat e lartpërmendura, për sa kohë Turqia do të ekzistonte në Evropë. Në qoftë se Turqia do të dëbohej nga Evropa, atëherë Shqipëria do të bëhej një shtet i pavarur, i qeverisur nga një princ evropian. Ndryshe nga disa qarqe shqiptare në Bullgari, Rumani dhe Egjipt, të cilat në vjeshtën e vitit 1912 u shprehën hapur për pavarësinë e Shqipërisë, “Vatra” dhe “Dielli” iu përmbajtën konceptit autonomist dhe nënvizuan me forcë rrezikun sllav dhe grek. Kjo ishte një veçori e cila, pa u futur në diskutimin pragmatist politik, provonte për karakterin e spikatur të politikës nacionaliste të “Diellit” dhe “Vatrës”.

Gjatë viteve 1910-1912 “Dielli” bëri thirrje të vazhdueshme për të mbështetur kryengritjet shqiptare. Ai ishte promotori dhe propaganduesi kryesor i fushatave për mbledhjen e ndihmave financiare për kryengritjen e Malësisë së Madhe të vitit 1911. Ai propagandoi edhe krijimin e një çete që do të shkonte në Shqipëri për të luftuar kundër turqve.

Sukseset e propagandës kombëtare tërhoqën edhe nacionalistë të tjerë në Amerikë. Ardhja e Kristo Floqit i cili zuri vendin e Konicës, si editor i “Diellit” në vitin 1910, i dha shtytje një fushate për konsolidimin e lëvizjes kombëtare nëpërmjet bashkimit të shoqërive lokale shqiptare. Pra, “Dielli” u bë promotori i diskutimit dhe propagandimit të ideve që çuan në formimin, në prill të vitit 1912, të Federatës Pan Shqiptare “Vatra”, e cila mbajti “Diellin” si organ të saj zyrtar. Madje, në ndonjë rast, ai ishte kritik ndaj atyre që ngurronin ose e pengonin këtë bashkim.

“Dielli” në përgjithësi u orientua drejt në rrethanat e vështira që kalonte Lëvizja Kombëtare Shqiptare dhe kjo është një tjetër arsye e suksesit të tij në fuqizimin e ndërgjegjes kombëtare shqiptare. Kështu ai i bëri një përcaktim të drejtë Aleancës Ballkanike të vitit 1912, duke e cilësuar atë një marrëveshje agresive e krijuar për të copëtuar tokat shqiptare¹. Ai mbrojt një vijë nacionaliste, duke hedhur poshtë çdo iluzion për një bashkëpunim të shqiptarëve me Fuqitë Ballkanike kundër Turqisë, të cilin e cilësonte si vetëvrasje².

“Dielli” përshëndeti shpalljen e Pavarësisë dhe, duke adaptuar vijën e Faik Konicës, i bëri jehonë pranimit të një princi evropian dhe shmangien e një princi muhamedan, duke bërë thirrje që Shqipëria të mos bëhej një shtet lindor, por një shtet evropian perëndimor si Norvegjia, Danimarka, Holanda ose Belgjika, me kulturë dhe ideale e tradita perëndimore. Ky ishte lloji i nacionalizmit dhe zgjimi kombëtar që predikonte “Dielli” qysh me themelimin e shtetit shqiptar. Kjo vijë e tij do të mbetej e pandryshuar, duke luftuar në të dy krahët çdo tendencë turkomane dhe çdo tendencë e veprimtari grekomane në ndërgjegjen e shqiptarëve. Duke ndjekur këtë rrugë, “Dielli” fitoi një meritë të pakontestueshme historike në formimin e një nacionalizmi modern shqiptar, jo vetëm në SHBA por në mbarë qendrat shqiptare, brenda e jashtë trojeve etnike, ku kjo gazetë lexohej me shumë interes.

Në vitin 1913 “Dielli” i bëri jehonë ndjekjes së një politike të re të lëvizjes kombëtare që ajo të kishte një orientim të pavarur nga Fuqitë e Mëdha, ndërsa në planin e brendshëm të qëndronte e paanshme dhe jashtë grupimeve politike që ishin formuar në Shqipëri³. Megjithatë edhe “Dielli”, në ndonjë rast, mori qëndrime të gabuara të cilat, gjithsesi, nuk e errësojnë kontributin e madh

¹ *Dielli*, “Sekreti i shteteve të Ballkanit”, 6 maj 1913.

² *Po aty*, 26 dhjetor 1912.

³ *Po aty*, 22 korrik dhe 2 dhjetor 1913.

që dha gazeta në zgjimin kombëtar dhe lëvizjen kombëtare. I tillë ishte rasti kur “Dielli”, nën influencën e Faik Konicës, përshëndeti krijimin e qeverisë së Esat Toptanit në Durrës dhe bëri thirrje për mbështetjen e saj⁴. Por, shumë shpejt, ky qëndrim u tejkalua dhe Esati u vlerësua, ashtu siç ishte, një aventurier antishqiptar.

Ndoshta fakti më interesant i zhvillimit të emigracionit shqiptar në Amerikë në dy dekadat e para të shek. XX ka qenë intensifikimi dhe rritja e ndërgjegjes kombëtare të emigrantëve shqiptarë, duke nxitur interesin e tyre për kulturën, traditat, historinë, interesat kombëtare dhe fatin e shqiptarëve, duke shtruar kështu rrugën për pjesëmarrjen e tyre aktive në betejën për arritjen dhe pastaj mbrojtjen e pavarësisë së Shqipërisë. Në vend që t’i nënshtroheshin një procesi asimilimi kulturor e shpirtëror nga shumica vendase, në vend që të bëheshin amerikanë, ata u bënë shqiptarë edhe më të thekur, edhe më të ndërgjegjshëm politikisht e kulturalisht. Një rol thelbësor këtu ka luajtur shtypi shqiptar në Amerikë, në qendër të të cilit spikat gazeta “Dielli”.

Pasojë e drejtpërdrejtë e zjarrit kombëtar që ndezi “Dielli”, e shpirtit nacionalist modern perëndimor që ai krijoi, ishin dhe vullnetarët e shqiptarëve të Amerikës, të cilët vërshuan në vitin 1914 në Shqipëri për të ndihmuar institucionet e reja të shtetit shqiptar. Ata ndeshën në një terren të vështirë i cili ishte i kontaminuar nga propaganda e fuqive të huaja dhe nga mbeturinat e forta të grekomanizmit dhe turkomanizmit. Por ata u shndërruan në një bërthamë nacionalistësh që ishin modeli i një Shqipërie të bashkuar, me institucione të pastra kombëtare. Ndonëse për momentin ata nuk mundën të shndërroheshin në një grup dominues e fitues, ata krijuan modelin dhe aspiratën e së ardhmes.

Gjatë regjimit të Princ Vidit, “Dielli” e mbështeti atë si kryetarin e shtetit shqiptar, por, nga ana tjetër, demonstroi qartë edhe kritikën ndaj tij, veçanërisht në kompozimin e qeverisë e cila mbizotërohej nga disa elementë çifligarë, pa të kaluar patriotike dhe madje edhe antipatriotë siç ishte E. Toptani. Dielli kërkoi vendosjen e qeverisë në duart e nacionalistëve shqiptarë⁵. Po kështu qeveria e Vedit u kritikua për lëshimet që i bëri lëvizjes vorio-epirote.

Një analizë të drejtë i bëri “Dielli” rebelimit në Shqipërinë e Mesme, duke theksuar se ai kishte karakter antikombëtar dhe se, në faza të ndryshme, kryengritja ishte e manipuluar nga fuqitë e huaja, të cilat e drejtuan atë në çdo rast kundër shtetit shqiptar, pavarësisë dhe stabilizimit të Shqipërisë⁶.

Prandaj, qysh në këtë kohë e deri në përfundim të Luftës I Botërore, “Dielli” u bëri thirrje nacionalistëve shqiptarë që të mos reshtnin së punuari për të shëndoshur gjendjen në Shqipëri, duke shtruar si detyrë themelore edukimin patriotik, luftën kundër propagandës së huaj, fanatizmit dhe dasive fetare, duke

⁴ *Po aty*, 4 nëntor 1913.

⁵ *Po aty*, “Për cilët u bë Shqipëria”, 8 maj 1914.

⁶ *Po aty*, “Gjendja e Shqipërisë”, 24 korrik 1914.

paralajmëruar se kjo do të ishte një luftë e gjatë, pasi plagët e grekomanizmit e turkomanizmit s' mund të shëroheshin menjëherë, por do të shkonin vite me radhë, gjersa shqiptarët fanatikë të pinin ilaçin e patriotizmit e të villnin helmin e farmakosur që kishin pirë gjatë sundimit osman⁷. Futja e vendit në rrugën e qytetërimit perëndimor dhe respektimi i çdo besimi vlerësohej si rruga më e sigurt për këtë qëllim dhe për progresin e Shqipërisë.

Konsolidimi i komunitetit shqiptar në SHBA në vitet 1910-1920 përkoi me procesin e ngritjes së shtetit të ri kombëtar, me stabilizimin dhe konsolidimin e tij. Duke qenë një komunitet që po përqafonin mënyrën amerikane të jetesës dhe po familjarizoheshin me kulturën amerikane, shqiptarët e Amerikës mbajtën në këmbë një gazetë të fuqishme, më e fuqishmja si dhe më jetëgjata në diasporat shqiptare. Kjo gazetë trajtoi, në një nivel të lartë për kohën, shumë probleme themelore të konsolidimit të kombit dhe shtetit shqiptar dhe kështu shërbeu shumë për të rritur ndërgjegjen kombëtare. Suksesi i mëtejshëm i “Diellit”, rritja e tirazhit të tij dhe e numrave, ishin një dëshmi tjetër e rëndësishme e ndikimit të tij në intensifikimin e panjohur më parë të ndjenjave kombëtare midis emigrantëve shqiptarë. Ky entuziazëm, ndjenja të tilla patriotike të cilat patën një shpërthim kaq të shpejtë në pak vite, ishte e vështirë të gjendeshin gjatë.

Një sprovë e rritjes së ndërgjegjes kombëtare shqiptare në Amerikë ishte edhe shuma prej 150 000 dollarësh që u mbledh për mbështetjen e Delegacionit Shqiptar në Evropë gjatë Luftës I Botërore. Kjo ishte një shumë kolosale, po të kemi parasysh vlerën e dollarit të asaj kohe dhe aq më tepër, pagat e ulëta të punëtorëve shqiptarë të Amerikës. Ky sukses i dedikohet në një shkallë të madhe edhe “Diellit” i cili, jo vetëm drejtoi me mjeshtëri këtë garë të madhe të kontributeve patriotike për lirinë, jo vetëm ishte promotori i palodhur i kësaj fushate, por edhe farkëtuesi entuziast i ndërgjegjes kombëtare shqiptare në Amerikë prej shumë vitesh.

Konaku shqiptar në Amerikë dhe kafenetë ku mblidheshin shqiptarët u bënë auditori kolektiv i “Diellit”, ku ai lexohej nga të mësuarit dhe komentoheshin nga të gjithë. “Dielli” dukej se u jepte atyre diçka nga vetvetja e munguar ose e harruar dhe, në mjaft raste, e rizbuluar. Ndërsa liderët nacionalistë përshkruanin në shtyp imazhet e madhështisë së ardhshme të Shqipërisë, ata po u jepnin lexuesve të tyre shembuj konkretë të vlerave dhe virtyteve të arsimit dhe edukatës kombëtare. Shprehjet: “pena është më e fortë se shpata”, “mësimi të jep suksesin”, “dija është shpëtimi i kombit dhe garancia e përparimit të tij”, ishin titujt e shpeshtë në gazetat shqiptare. Diplomatat italianë në Washington, që e ndiqnin nga afër aktivitetin e emigracionit shqiptar, ishin të mahnitur me shtypin shqiptar në Amerikë, të cilin e quanin shqisën e gjashtë të këtij emigracioni.

⁷ *Po aty*, “Dëshpërimi i nacionalistëve shqiptarë”, 14 gusht 1914.

Një nga aspektet më të rëndësishme të zhvillimit të emigracionit shqiptar në SHBA ishte përparimi në fushën kulturore. Intelektualët e shquar shqiptarë: Peci, Noli, Konica, Dako, Petro Nini Luarasi etj., që në fillim e patën të qartë se nuk mund të realizohej zgjimi kombëtar pa një media të fuqishme informative dhe kulturore. “Dielli” qëndronte në qendër të shtypit kombëtar dhe është kontributori kryesor në realizimin e këtij progresi. Dimensioni statistikor është se nga një grusht shqiptarësh që mund të shkruanin dhe lexonin shqip, kur Peci botoi për herë të parë “Kombin”, në vitin 1920, shtypin shqiptar e lexonin 15 000 vetë nga 30.000 që ishin atëherë në SHBA.

Një vlerë të veçantë ka “Dielli” sepse bëri hapa konkretë e praktikë të vlefshëm për unifikimin gjuhësor. Bashkëpunëtorët dhe redaktorët e “Diellit” e dinin se po i drejtoheshin një auditori gjithëshqiptar, prandaj ata ishin të detyruar të shkruanin në një gjuhë të thjeshtë e me sa më pak dialektalizma. Ky ka qenë një kontribut tjetër i “Diellit” në këtë fushë e cila është një nga themelet e unifikimit kombëtar. Në fakt, në dy dekadat e para, në shkrimet e Diellit mbizotëronte dialekti toskërisht, por “kjo ishte një gjuhë aq e qëruar dhe e rrafshët, sa do ta kishte kuptuar çdo gegë që kishte një përgatitje kulturore.”⁸

Fushata kryesore e “Diellit” ishte ajo për mbrojtjen e tërësisë tokësore të Shqipërisë. “Dielli” dha dhjetëra argumente historike, etnike, politike, kulturore që provonin se territoret e lakmuara nga serbët e grekët ishin qartësisht shqiptare. Kjo betejë që ishte intensive në dy dekadat e para të shek. XX, por që zgjati gjatë gjithë historisë 100-vjeçare të “Diellit”, përveç të tjerash, pati një rezultat madhor: Ajo arriti të elaborojë etnicitetin shqiptar, historinë, kulturën, dhe të kultivojë më tej ndërgjegjen kombëtare shqiptare, duke e pasuruar dhe konsoliduar atë në shumë drejtime, duke dhënë kështu një kontribut madhor në zgjimin kombëtar shqiptar dhe për konsolidimin e unifikimin e kombit shqiptar.

“Dielli” u angazhua në një luftë të ashpër për denoncimin e intrigave dhe propagandës së shtypit grek, i cili kishte shpalosur platformën e tij të gjerë për dezinformimin e opinionit publik mbi ngjarjet në Shqipërinë e Jugut dhe karakterin etnik të kësaj krahine. Këtu ishte e gjithë qendra e gravitetit të punës së kësaj gazete, e cila i dha një impuls të paparë forcimit të ndërgjegjes kombëtare shqiptare.

“Dielli” denoncoi ashpër edhe dhespotët grekë në Shqipërinë e Jugut që kishin hedhur kryqin e shenjtë përdhe, e kishin shkelur dhe e kishin bërë vegël vrasëse⁹. Ai sulmoi ashpër përpjekjet e Patrikanës për imponimin e venomeve dhe kapitulacioneve të kohës osmane në Shqipëri, duke i cilësuar ato si të rrezikshme që do të çonin në dezintegrimin e Shqipërisë. “Dielli” konsideroi si

⁸ Martin Camaj, “Mbi funksionin e gjuhës së Nolit dhe të Konicës” në: *Seminari Ndërkombëtar i Federatës Panshqiptare “Vatra”*, New York, 28-30 nëntor 1969, f.109-116.

⁹ *Dielli*, 18 gusht 1913.

një rrezik kryesor për shtetin shqiptar dasitë krahinore e fetare dhe u përpoq t'i japë qeverisë një program efektiv për eliminimin e tyre. Kjo gazetë propagandoi vazhdimisht ndarjen e fesë nga shteti dhe nga sistemi arsimor publik, pasi vetëm kështu Shqipëria do të shpëtonte nga shumë ngatërresa të mëdha¹⁰.

Si një mjet efikas lufte kundër grekomanizmit "Dielli" përdori një metodë të zgjuar, duke botuar emrat e atyre që mbështesnin propagandën greke kundër Shqipërisë. Por në përpjekjet për të luftuar reaksionin grekoman e turkoman spikaste fryma racionale e edukative, duke u përpjekur për t'u shpjeguar bashkatdhetarëve gabimet e tyre: "Grekomanët dhe turkomanët, - shkruante "Dielli", - janë fanatikë që u mungon vetëdija dhe janë të dëshpëruar nga rrojtja e ligë. Prandaj kombëtarët duhet, me durim, t'u shpjegojnë se ç'është kombësia, ç'rëndësi ka ajo, gjuha dhe zakonet. Ata që duhet të ndiqen pa mëshirë, janë udhëheqësit e kundërshtarëve tanë, të cilët e dinë fort bukur që janë shqiptarë por, meqë paguhen mirë nga armiqtë e Shqipërisë, janë të interesuar të predikojnë tradhëtarizmin"¹¹.

Në fund të Luftës së Parë Botërore dhe gjatë Konferencës së Paqes pretendimet aneksioniste greke morën një vrull të ri. Bashkimi Pan Epirot i organizuar në vitin 1913 i cili përfshinte edhe shqiptarë grekomanë nga Massachusetts, i dërgoi në maj 1919 Konferencës së Paqes një Memorandum të gjatë i nënshkruar nga rreth 1300 banorë nga Korça e Gjirokastra, në të cilin kërkohet aneksimi i këtyre krahinave nga Greqia. Dielli zhvilloi një fushatë të fuqishme për denoncimin dhe kundërbalancimin e propagandës greke dhe, për lavdinë e tij e për fatin e mirë të Shqipërisë, arriti ta fitojë atë.

Me mbarimin e Luftës së Parë Botërore dhe me restaurimin e pavarësisë së Shqipërisë, për koloninë shqiptare në SHBA, filloi një etapë e re. "Dielli", tashmë, krahas mbrojtjes së çështjes kombëtare, u angazhua në diskutime të gjera për mënyrën e ndërtimit të shtetit të ri dhe për ndërtimin e institucioneve kombëtare. Ai mbajti gjithmonë anën e interesave kombëtare dhe të demokracisë, duke u përpjekur që natyra e këtyre institucioneve të ishte sa kombëtare, aq edhe demokratike. "Dielli" u bë protagonist i zellshëm i demokracisë dhe qytetërimit amerikan, duke i vënë këto në shërbim të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. "Dielli" dhe "Vatra", roli i të cilave nuk mund të ndahet, ishin faktorët më të rëndësishëm, ndonëse jo të vetëm që po luftonin për një shtet kombëtar modern me tipare dhe institucione të përgjegjshme e efektive, por edhe demokratike e moderne.

"Dielli" përfaqëson orientimin më progresiv në shtypin shqiptar, duke kultivuar rrymën nacional-demokratike në mendimin politik-social shqiptar. Ta bëjë këtë në kushtet e atëhershme të Shqipërisë nuk ishte një gjë e lehtë, por

¹⁰ *Po aty*, 4 nëntor 1913.

¹¹ *Po aty*, 20 qershor 1913.

idealizmi i intelektualëve shqiptarë të Amerikës ishte i pathyeshëm dhe pa kompromis, ndërsa largpamësia e tyre mbetet e admirueshme. Ata mbollën me ndërgjegje filizat që kishin besim se do të rriteshin të shëndetshëm e të fuqishëm në të ardhmen. Në këtë mënyrë ata krijuan një trashëgimi të vyer në ndërgjegjen kombëtare shqiptare, duke ngritur njëkohësisht dy shtylla themelore të saj: patriotizmin modern dhe idealet demokratike përparimtare perëndimore.

“Dielli” ishte shkolla dhe universiteti i madh për qindra shqiptarë që do të ktheheshin në Shqipëri në vitet '20, të cilët ishin pjesa më progresive e shoqërisë dhe ndërgjegjes kombëtare shqiptare. Në vitet 1919-1925 rreth 20 000 shqiptarë u kthyen në atdhe nga Amerika. Grupi i shqiptarëve të Amerikës që u bënë zyrtarë qeverie, deputetë, prefektë, nënprefektë, komisarë policie, oficerë ushtrie dhe mësues, i bënë shërbime të mëdha vendit. Të gjithë ata kishin kaluar nëpër shkollën e madhe të “Diellit” dhe të “Vatrës”. Madje, edhe priftërinjtë u importuan nga Amerika për arsye të formimit dhe eksperiencës së tyre patriotike.

Tashmë edukata nacionaliste e “Diellit” dhe “Vatrës” po shërbente në Shqipëri. Ata përfaqësonin krahun nacional-demokrat në skenën politike shqiptare. Nacionalistët e Amerikës gjatë këtyre viteve u ndeshën me ideologji dhe rryma politike konservatore. Grupi i shqiptarëve nacionalistë të Amerikës do të ishte më i fuqishëm dhe më influent se sa në vitet 1913-1914 dhe ai dha një kontribut të shquar në formimin e konsolidimin e mëtejshëm të ndërgjegjes dhe institucioneve kombëtare. Kështu p.sh. ata ishin grupi më i fuqishëm që i rezistoi dhe kundërshtoi memorandumun autonomist të një grupi nga paria e Korçës në vitin 1922, si dhe kampioni i përpjekjeve për kombëtarizimin e arsimit e të kishës ortodokse në Shqipëri. Ndoshta pa e kuptuar, ata, të formuar prej vitesh nga “Dielli” me ideale kombëtare e demokratike, ishin shndërruar në themeluesit e nacionalizmit demokratik shqiptar, ndonëse dukej se beteja e tyre ende kishte pak shanse për sukses. Koha e tyre ende nuk kishte ardhur, por ata mbollën farën e së ardhmes, së cilës i përkisnin. Në ato vite ata pësuan shumë zhgënjime e deziluzione, por më vonë, kur ujërat do të qetësoheshin, do të kuptohej se këta patriotë kishin lënë një trashëgimi tepër pozitive për të ardhmen e Shqipërisë.

Nën drejtimin e Konicës, “Dielli” nisi një sulm të hapur kundër aristokracisë së tokës dhe pasuesve të saj, duke mbështetur Fan Nolin, i cili ishte një udhëheqës aktiv i opozitës. Siç thuhej në një kryeartikull të “Diellit”: tashmë “Vatra” do të luftonte kundër bejlerëve që kishin qenë kundërshtarë të kauzës nacionale dhe do të luftonte për një Shqipëri të civilizuar e të kulturuar. Kjo politikë e Konicës e shprehur në gazetën “Dielli” e thelloi antagonizmin brenda “Vatrës”.

Mbi karakterin human, demokratik dhe properëndimor të kësaj gazete dëshmojnë shumë artikuj e qëndrime që ajo ka mbajtur. Por ne mund të veçojmë tre çështje kryesore:

1 – përpjekjet konsekuente për ta ndërtuar shtetin shqiptar në bazë të modelit perëndimor dhe institucioneve perëndimore;

2 – kultivimi i qëndrimeve politike realiste e integruese, siç ishte rasti i qëndrimit ndaj Maqedonisë para dhe pas Luftës së Parë Botërore, apo qëndrimi ndaj përpjekjeve për krijimin e një Federate Ballkanike. Për Maqedoninë sugjerohej si zgjidhje e vetme që ajo të vetëqeverisej në formën e një shteti federativ, si Zvicra, ku kantonet të formoheshin në bazë të përkatësisë kombëtare të shumicës dërrmuese të popullsisë. Ato do të kishin gjuhën e tyre amtare si gjuhë zyrtare. Ky koncept ishte shumë i avancuar e progresiv dhe, siç shprehej “Dielli”, ai mbyllte një herë e përgjithmonë çështjen e Maqedonisë, që kishte shkaktuar kaq gjak dhe kishte sjellë kaq mjerime midis popujve të Ballkanit. Ndërsa për sa i përket Federatës Ballkanike “Dielli” denoncoi përpjekjet sllave që me këtë projekt, synonin dominimin e popujve të tjerë të Ballkanit. “Dielli” nuk iu kundërvu idesë së bashkimit e integritetit të popujve ballkanikë por denoncoi deformimin shovinist të saj nga serbët dhe grekët. Ai këmbënguli që deviza “Ballkani – Ballkanasve” duhej të shoqërohej pa tjetër me devizën: “Shqipëria – Shqiptarëve”, dhe provoi qartë se harmonia në Ballkan mund të ndërtohej vetëm mbi bazën e respektimit të kriterit etnik.

3 – Një qëndrim shumë progresiv mbajti gazeta ndaj pakicave në Shqipëri. Me gjithë vuajtjet dhe persekutimet që po hiqnin shqiptarët nga shtetet fqinje, këto nuk bënë që “Dielli” të humbiste toruan apo karakterin human e progresiv që ka spikatur gjithmonë qëndrimet e tij. Dielli gjithmonë bëri thirrje për respektimin dhe bashkëjetesën harmonike me të gjitha pakicat. Ai përshëndeti dëshirat e vllahëve dhe bullgarofonëve (maqedonasve të Prespës) për t’u përfshirë në shtetin shqiptar dhe propagandoi njohjen e të gjitha të drejtave të këtyre pakicave si dhe të pakicave të tjera etnike, duke nënvizuar se, vetëm nën shtetin shqiptar, ata do të mund të ruanin identitetin e tyre dhe do të gëzonin një liri të plotë. Ndërsa në të kundërt, duke mbetur nën shtetet e tjera, do të humbisnin kombësinë e tyre¹². Por interesant është se “Dielli” dinte të ruante dhe masën dhe kritikoi hapur disa tendenca jorealiste që u shfaqën në Kongresin e Triestes, ku u bënë propozime për krijimin e një mbretërie shqiptaro-rumune, e ngjashme me Austro-Hungarinë apo për një autonomi territoriale të vllahëve brenda shtetit shqiptar¹³.

“Dielli” dhe “Vatra” janë një monument i madh i shqiptarizms, që ndikuan fuqishëm në ruajtjen e karakterit kombëtar të shqiptarëve të Amerikës, duke siguruar krenarinë dhe dinjitetin e tyre dhe duke provuar në këtë mënyrë

¹² *Po aty*, “Rumunët në Shqipëri”, 11 mars 1913.

¹³ *Po aty*.

se çfarë mrekullish mund të bëjë një popull që është kryelartë për prejardhjen e vet kur ai lejohet të japë prova të zotësisë së tij. Po e mbyll këtë referat me përcaktimin e Hasan Dostit 40 vjet më parë i cili shprehej plot elokuencë, por edhe me realizëm se: “Dielli” dhe “Vatra” na zgjuan idenë e zjarrit të dritës, që do të thotë, flakë patriotizmi dhe rreze kulture”¹⁴.

¹⁴ Hasan Dosti, “60-vjetori i fletores “Dielli””, në *Seminari Ndërkombëtar...*, f.183.